

VENDIM
Nr. 242, datë 23.9.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË, PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ

(ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 7.10.2022)

Në mbështetje të neneve 83, 85, 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 12, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, i ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1610/1 prot., datë 21.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me anë të shkresës nr. 6358, datë 20.9.2022, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për konsumin e energjisë elektrike mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë, për arsye të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike që prokurohet për qëllime të mbulimit të nevojës së FSHU sh.a., nga shoqëria Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.), mbështetur në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 6645/1, datë 8.9.2022, në të cilën është vendosur që çmimi për energjinë e klientëve familjarë për konsumin mbi 800 kWh/muaj të jetë 34.3 lekë/kWh.

- Shoqëria FSHU sh.a., ka bërë me dije:

- shtesa e shpenzimeve të blerjes së energjisë do të duhet të rrisë edhe koston vjetore të blerjes së energjisë për vitin 2022;

- shpenzimet faktike bazuar në të dhënat e 8-mujorit dhe të parashikuara për gjithë vitin 2022, si dhe ato për vitin 2023, janë të ndryshme nga ato të marra në konsideratë në llogaritjet e ERE-s, për korrigjimin e të cilave FSHU sh.a., duhet të shprehet në dokumentin e aplikimit për çmimet e shitjes me pakicë për klientët që furnizohen prej saj;

- sipas parashikimeve të FSHU sh.a., ndër të tjera për llogaritjet e kostove duhet të plotësohen me koston e blerjes së energjisë, si dhe me koston e shtuar të borxhit të keq të ndikuar nga rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh/muaj.

- Kostoja për njësi e borxhit të keq, në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022 “Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.5.2022–31.12.2022” është llogaritur të jetë 0.53 lekë për kwh, ndërkohë FSHU sh.a., kërkon t’i njihet një kosto e borxhit të keq në nivelin 0.68 lekë/kwh si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes së energjisë për periudhën tetor–dhjetor 2022 nga KESH sh.a., e cila është për llogaritur bazuar në normën e arkëtimit të përdorur në këto llogaritje, në masën prej 95% sipas vendimeve të qeverisë shqiptare në Planin e Konsolidimit Financiar.

- ERE, me anë të vendimit nr. 74, datë 13.4.2022, kreu vlerësimet e tij për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.5.2022–31.12.2022, duke konsideruar dhe transferimin e kostove të aktivitetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë dhe koston e blerjes së energjisë elektrike, si dhe duke për llogaritur efektet e tyre në çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a., për periudhën 1.5.2022–31.12.2022.

Me anë të vendimit të sipërcituar, ERE vendosi që çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021.

- FSHU sh.a., ka propozuar njohjen e kostos së blerjes së energjisë elektrike për klientët familjar që do të konsumojnë mbi 800 kWh/muaj me një vlerë prej **1820 milionë lekë**, për periudhën tetor–dhjetor 2022, e cila bashkë me kostot e tjera shoqëruese të evidentuara më sipër, rezulton me një çmim shitjeje të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh prej **42.95 lekë/kWh**.

- Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022 vendosi të miratojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Në nenin 4, pika 7, të këtij vendimi përcaktohet se ai është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, për të cilin Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 256, datë 29.4.2022 vendosi se i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2022.

- Detyrimi i shërbimit publik i vendosur nga Këshilli i Ministrave ndër të tjera përcakton detyrimin e KESH sh.a., për furnizimin me energji elektrike për të gjithë klientët të cilët furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga FSHU sh.a. Në përputhje me VKM-në sipërcituar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a., me anë të vendimit nr. 6645/1, datë 8.9.2022 ka vendosur në pikën 1 të tij, miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., sipas tabelës vijuese:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, deri në 800 KWh/Muaj	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, mbi 800 KWh/Muaj	34.3 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

- Çmimi i aplikueshëm për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike, të cilat janë rritur në mënyrë eksponenciale në tregun rajonal dhe evropian të energjisë dhe nuk prek çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët familjar që konsumojnë deri në 800 kWh/muaj, si dhe të gjithë konsumatorët jofamiljarë për faktin se nuk ka ndryshim të tarifave të përdorimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Kërkesa e paraqitur nga shoqëria FSHU sh.a., mbi nevojën e përballimit të kostove shtesë për blerjen e energjisë elektrike, përbën interes të lartë publik në kuadër të garantimit të furnizimit me energji elektrike dhe të menaxhimit të situatës së krizës energjetike, për të cilën Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e emergjencës, si dhe është e mbështetur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përcakton se qëllimi kryesor i tij është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve fundorë.

- Kërkesa e paraqitur për shqyrtim nga shoqëria FSHU sh.a., i plotëson kushtet e parashikuara në nenin 12, të Kodit të Procedurave Administrative, duke marrë në konsideratë garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve fundorë, si dhe gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, të shpallur nga Këshilli i Ministrave.

- Vlerësohet e nevojshme, njohja e kostove shtesë të blerjes së energjisë nga shoqëria e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me energji elektrike të klientëve. të cilët furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, përtej atyre të pranuar në vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, të Bordit të ERE-s (Asambleja e Përgjithshme e KESH-it me vendimin nr. 1349/1, datë 16.2.2022, “Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2022 parashikimin 2023–2026”, ka vendosur, ndër të tjera, se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që shërbehen nga FSHU sh.a. do të jetë 2.6 lekë/kWh), me qëllim sigurimin e likuiditetit të nevojshëm

për realizimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike mbështetur në detyrimin e shërbimit publik.

- Bazuar në nevojën për të ardhura prej rritjes së kostos së blerjes së energjisë dhe pasiguritë e realizimit të kostove të tjera të furnizimit, vlerësohet se çmimi prej 42 lekë/kWh për konsumin familjar mbi 800 kWh/muaj rikuperon koston e blerjes së energjisë duke siguruar likuiditetin e nevojshëm për shoqërinë FSHU sh.a., me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

- Shoqëria dhe OSSH sh.a., duhet të marrin masa për respektimin në mënyrë rigorozë të afatit prej 30 ditë kalendarike për leximin dhe faturimin e energjisë elektrike, të përcaktuar në nenin 11 të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” të miratuar me vendimin nr. 15, datë 10.1.2018, të Bordit të ERE-s, me qëllim mbrojtjen e të gjithë klientëve familjarë nga çdo keq faturim i mundshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekësh/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj, për klientët familjarë, për periudhën 1 nëntor–31 dhjetor 2022.

2. Ndryshimet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për periudhën 1 tetor–31 dhjetor 2022 reflektohen në tabelën bashkëlidhur vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022.

3. Shoqëritë FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a., të raportojnë rregullisht në ERE mbi leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të klientëve familjarë, duke respektuar afatin prej 30 ditësh kalendarike, sipas përcaktimeve në nenin 11 të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, miratuar me vendimin nr. 15, datë 10.1.2018, të Bordit të ERE-s.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1 TETOR–31 DHJETOR 2022

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (lek/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (lek/kWh)
* Çmimi i shitjes për klientët në 20 kV	11	12.65
* Çmimi i shitjes për klientët në 10/6 kV	11	12.65
* Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
* Çmimi i shitjes për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4	14.3
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Objekte kulti/bashkësi fetare	9.5	
Familjarë konsumi deri në 800 kWh/muaj	9.5	
Familjarë konsumi mbi 800 kWh/muaj	42	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
* Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe/ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i këtyre çmimeve		

*** Orari pikë gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pikë është:*

- Për periudhën 1 nëntor – 31 mars nga ora 18:00 deri në 22:00

- Për periudhën 1 prill – 31 tetor nga ora 19:00 deri në 23:00